



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI

Nr. 489/15 Prot.

Tiranë, më 15.05.2020

VENDIM

Nr. 28, datë 15.05.2020

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES MBI MASAT SANITARE PËR
MINIMIZIMIN E RISKUT NGA COVID -19,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

Në mbështetje dhe në zbatim të pikës 1/d, nenit 38, të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH", Senati

VENDOSI :

1. Të miratojë Rregulloren mbi masat sanitare për minimizimin e riskut nga Covid -19, në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT


PROF.DR.AGRON ÇUKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Rregullore
mbi
Masat Sanitare për Minimizimin e Riskut
nga COVID-19



Tiranë, Maj 2020

Përmbajtja

1.HYRJE

2.SHMANGIA E RASTEVE TË DYSHUARA DHE HYRJA DALJA
NE AMBJENTET E UST

3.DISTANCIMI FIZIK

4.MBAJTJA E MASKAVE DHE DOREZAVE

5.DESIFEKTIMI DHE HIGJENA

6.TË NDRYSHME

1.Hyrje

Universiteti i Sporteve të Tiranës, në kushtet e pandemisë nga COVID 19, ka qenë i detyruar të kufizojë disa aktivitete arsimore dhe të adaptojë proceset akademike.

Aktiviteti arsimor është kategorizuar si aktivitet **me risk të lartë në** planin kombëtar të ri-hapjes së shoqërisë.

Ndërkohë që mbyllja me sukses e vitit akademik kërkon realizimin brenda verës së vitit 2020 të disa proceseve mësimore, përfshirë leksione, praktika dhe provime (Vendim qarkullues Nr. 28,15/05/2020: linku nga www.ust.edu.al), është e domosdoshme që të sigurohet kryerja e tyre në kushtet e sigurisë shëndetësore më të lartë të mundshme, për studentet dhe personelin e Universitetit.

Plani i masave të minimizimit të riskut kundrejt COVID-19 për Universitetin e Sporteve të Tiranës është në linjë me planin kombëtar të qeverisë së Shqipërisë dhe do të adaptohet në dinamikë, në varësi të fazave të pandemisë dhe njohurive shkencore mbi infeksionin.

Objektivi i masave të përfshira në këtë rregullore është të minimizojnë riskun për infektimin nga COVID-19, përmes praktikave të distancimit fizik dhe dezinfektimit.

Për të gjitha rastet kur është e domosdoshme të kryhet aktiviteti akademik me prani fizike të studentëve duhen zbatuar masat e mëposhtme:



2.Shmangia e rasteve të dyshuara dhe hyrja-dalja në ambjentet e UST

Studentët me shenja të sëmundjes (<https://infocoronavirus2019.al/simptomat/>) këshillohen të qëndrojnë në shtëpi dhe të informojnë sekretarinë mësimore ose pedagogun e lëndës përmes telefonit. Sekretaria mësimore ose pedagogu informon në dekanat për çdo rast të evidentuar.

Orari i studentëve në UST rregullohet sipas një grafiku të hartuar nga fakultetet dhe në monitorimin e pedagogëve përkatës.

Studentët paraqiten në UST duke respektuar me përpikmëri orarin e komunikuar nga Fakulteti përkatës.

Studentët hyjnë në UST pasi janë vendosur në radhë një nga një , me largësi 1.5 deri në 2 m.

Studentët që kanë simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në UST , njofton stafin akademik ose personin e përcaktuar nga Fakulteti, i cili bashkëpunon me mjekun e familjes , verifikon nëse studenti është i sëmurë apo jo.

Para hyrjes në godinën kryesore ku zhvillohet procesi i mësimdhënies, personi përgjegjës i caktuar nga fakulteti për studentët dhe stafin akademik dhe për administratën nga stafi administrativ kryen për çdo individ sipas listave përkatëse.

- Verifikimin e temperaturës me termometër dixhital;
- Verifikimin e pajisjes me maskë dhe doreza personale;
- Sprucim me alkol 60% ose desifektantë të tjerë.

Nuk lejohet që studentët të dalin nga godina dhe të rikthehen përsëri në të brenda ditës.

Lejohet vetëm një hyrje dhe dalje në ndërtesën e UST.

Dalja në ambjentet e tij do të bëhet sipas rregullave, duke ruajtur distancimin social dhe fizik si më lart (1.5 deri në 2 m), nën mbikqyrjen e pedagogëve dhe stafit ndihmës mësimore të UST.

Studentët që nuk zbatojnë këtë rregullore trajtohen me masë disiplinore sipas rregullores së UST.



3. Distancimi fizik

Në mjediset e jashtme ruhet distanca prej të paktën 1.5 metra mes studentëve, duke vendosur shenja orientuese dhe duke afishuar informacion të dukshëm.

Në klasë/auditor ruhet distanca prej 2 metra mes studentëve. Nëse numri i studentëve është më i madh se sa hapësira e klasës që do të duhej për të respektuar këtë kusht, mësimi zhvillohet në më shumë se një grup apo klasë.

Përshtatja e orareve lidhur me shtimin eventual të leksioneve do të bëhet në marrëveshje mes departamenteve dhe Dekanatit përkatës.

Departamentet, në bashkëpunim me Dekanatin organizojnë vendosjen e tavolinave dhe shenjave orientuese në përputhje me rregullin e cituar më lart mbi distancën fizike mes studenteve në mjedise të mbyllura.

Ruajtja e distancës fizike të cituar më sipër për mjediset e mbyllura, aplikohet edhe në çdo formë tjetër të komunikimit mes pedagogut dhe studentit, përfshi konsultimet apo provimet.

Studentët në çdo hyrje në mjedisin e mbyllur ku do të zhvillohet aktiviteti mësimor, verifikohen nga personi përgjegjës për temperaturën dhe pajisjen me maskë dhe doreza.

Orari i leksionit, praktikës apo provimit duhet të sigurojë shmangjen e grumbullimit të më shumë se një grupi studentësh në mjedisin e mbyllur ku do të zhvillohet procesi mësimor.

Në çdo mjedis të mbyllur ku zhvillohet leksion, praktika apo provime, afishohen masat e parashikuara në këtë rregullore.

Kur është e mundur, mësimi praktikohet në ambjent të hapur duke respektuar largësinë në rregullat e mësipërme.

Nuk lejohet ushqimi në salla .

Lëvizja e studentëve në salla laboratorë apo palestra dhe në korridorë duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë që në çdo zonë të ketë një numër minimal të individëve që lëvizin në to, kjo vetëm kur hyjnë në ambjentet ku do të zhvillohet mësimi ose për përdorim të tualetit , pa takuar në asnjë moment studentë të tjerë.

Rregullat për lëvizjen e studentëve duhet të jenë të afishuara në ambjentet e sallave dhe në korridore.

Komunikimi në rast nevojë i studentëve me drejtuesit, sekretarinë, stafin ndihmës apo administratën e UST do të kryhet nëpërmjet pedagogut përgjegjës duke respektuar distancimin social e fizik dhe rregullat e tjera të përcaktuara me lart. Mund të jetë nëpërmjet telefonit apo e-mail, kur studenti nuk ndodhet në sallë.

Nuk do të përdoren materiale të printuara, përveç rasteve kur studentët kanë libra, të cilët i mbajnë tek sendet personale ose në shtëpi.

Nuk do të kontaktohen personat që mund të jenë të pranishëm në mjediset e Universitetit.

Nuk lejohet asnjë aktivitet tjetër arsimor veç atyre më të domosdoshëm, të përcaktuar në Vendimin përkatës të Rektoratit (Vendim qarkullues Nr. 28 ,datë 15/05/2020:linku nga www.ust.edu.al) .



4.Mbajtja e maskave dhe dorezave

Në klasë/auditor dhe në të gjithë mjediset e mbyllura studentët dhe personeli, mbajnë maska dhe doreza(<https://infocoronavirus2019.al/perdorimi-i-maskes/#>).

Në hyrjen e çdo mjedisi të mbyllur afishohet një kujtesë lidhur me mbajtjen e maskave dhe dorezave.

Pedagogët sigurohen që në auditore të gjithë studentët të jenë të pajisur me maskë dhe doreza dhe t'i mbajnë rregullisht ato.

Gjatë procesit mësimor pedagogu qëndron në sallë duke respektuar distancimin social dhe fizik me studentin në 1.5 deri 2 m largësi.

Nuk lejohen qëndrime në korridore.

Studentët të mbajnë largësinë minimale 1.5 deri 2 m kur lëvizin në korridore.



5. Dezinfectimi dhe higjena

Personeli dhe studentët dezinfektojnë duart gjatë hyrjes/daljes në/nga klasë/auditor duke përdorur kontenierët e vendosur për këtë qëllim në katin përkatës ose do të përdoret nga stafi që do të caktohet për këtë problem.

Studentëve duhet t'ju flitet në mënyrë të vazhdueshme për rregullat e higjenës, larjen e duarve, mënyrën e kollitjes dhe teshtimës .

Çdo student në UST duhet të lajë duar pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit: prekja e hundës, syve , gojës etj.

Duhet të sigurohet uji i rrjedhshëm, sapuni i lëngshëm, letra për fshirjen e duarve dhe xheli me përmbajtje alkoli 60% në UST.

Sipërfaqet e tavolinave në auditore dezinfektohen pas çdo aktiviteti arsimor duke përdorur produktet për këtë qëllim.

Sigurohet ajrosja e vazhdueshme e klasave apo auditoreve para, gjatë dhe pas aktivitetit mësimor.

Në hyrjen e klasës afishohet një kujtesë mbi dezinfektimin e duarve dhe të sipërfaqeve të tavolinave (<https://infocoronavirus2019.al/parandalimi/>)

Të jenë të afishuara në të gjitha ambientet e Universitetit postera mbi masat për parandalimin e COVID -19 të cilat të paraqesin mesazhe të thjeshta dhe të qarta.

Të vendosen postera të veçantë për mënyrën e larjes së duarve.

Korridoret e mjediseve ku zhvillohet aktiviteti arsimor pastrohen/dezinfektohen çdo dy orë.

Tualetet pastrohen/dezinfektohen çdo 30 minuta.

Rezervuarët e ujit që mund të ketë UST u hidhet klor sipas udhëzimeve përkatëse çdo ditë.

Dorezat, parmakët dhe sipërfaqe të tjera në mjediset pranë sallës/auditorit ku zhvillohet aktiviteti arsimor, pastrohen/dezinfektohen çdo 30 minuta.

Sanitaret të mbajnë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solucione dizinfektuese.

Dritaret duhet të mbahen të hapura, klasat, auditorët, laboratorët të ajrosen 5-6 herë gjatë kohës së mësimi.

Në një klasë, sallë apo laborator të mos qëndrojnë më shumë studentë se sa mund të qëndrojnë në atë mjedis, duke respektuar distancimin social dhe fizik.

Në përfundim të procesit mësimor kryhet pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe orendive me lëndë dezinfektuese dhe i mjediseve të përbashkëta.

6.Të ndryshme

Do të pranohen në ambientet e UST, vetëm studentët që do të firmosin rregulloren mbi parandalimin e përhapjes së COVID -19.

Përpara se të rifillojnë mësimin në ambientet e UST, sipas rregullave të reja për parandalimin e përhapjes së Covid -19, studentët duhet të plotësojnë Formularin e Vetedeklarimit për situatën e tyre shëndetësore dhe të familjarëve të tyre, e cila shërben për të hetuar paraprakisht mundësinë e një vatre infeksioni Covid -19.

Studenti nënshkruar në mënyrë elektronike tek pedagogu këtë rregullore.

Studentët që nuk zbatojnë rregulloren, trajtohen me masë sipas rregullores së UST.

Aktivitetet jashtë shkollore, sportive e artistike në grup janë të ndaluara.

Drejtuesit e Universitetit të Sporteve të Tiranës përmes komunikimit elektronik me strukturat e shëndetit publik, policinë e shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese për ecurinë e procesit mësimor.

Për çdo student që paraqet probleme shëndetësore, si p.sh rritje të temperaturës etj. apo ka një njoftim që studenti ka patur kontakt me dikë të prekur me Covid -19 si dhe në se prindi përkatës është i sëmurë, apo ka patur kontakte me Covid -19, lajmëron menjëherë njësinë vendore të kujdesit shëndetsor dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

Për çdo pedagog apo personel tjetër të Universitetit të Sporteve të Tiranës, i cili paraqet probleme shëndetësore, si rritje të temperaturës etj, apo ka patur njoftim se ka patur kontakt me dikë të prekur me Covid -19, lajmëron menjëherë njësinë vendore të kujdesit shëndetësor dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

Bashkangjitur kësaj rregullorje modeli i vetdeklarimit dhe posterit informues.

REKTORI

Prof. Dr. Agron Cuka



FORMULAR VETËDEKLARIMI COVID 19

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

<u>Mbiemri, Emri</u>	
<u>Atësia/Amësia</u>	
<u>Datëlindja</u>	
<u>Vendlindja</u>	
<u>Dokumenti i identifikimit</u> (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: i/e painfektuar. i/e infektuar

Gjendja shendetesore e familjareve te mi eshte: i/e painfektuar. i/e infektuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

Emër Mbiemër / Firmë

Emër Mbiemër / Firmë / Vule

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor _____


Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues


Data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517 date 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".


Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.




RREGULLA QË DUHET TË ZBATOJMË PËR T'U MBROJTUR NGA COVID-19 NË UST




MBAJ MASKË




**HYRJA NË UST
DUKE RUAJTUR
DISTANCËN 2 M**




**DISTANCIM SOCIAL
2 METRA,
NË ÇDO AMBIENT**



**PRIT NË RADHË PËR MATJEN E
TEMPERATURËS DHE DEZINFETIMIN
E DUARVE ME ALKOOL 60%**



**LAJI DUART PËR
20 SEKONDA**



**MOS PREK ME DUAR
SYTË, HUNDËN
DHE GOJËN**

- NUK LEJOHEN QËNDRIMET NË KORRIDORE.
- NUK LEJOHET DALJA GJATË ORËS SË MËSIMIT, PËRVEÇ RASTEVE KUR JU DUHET TË PËRDORNI TUALETIN.
- LEJOHET VETËM NJË HYRJE-DALJE NGA NDËRTESA E UST
- EVITONI KONSUMIMIN E USHQIMIT NË KLASË.

JU LUTEMI TË RESPEKTONI ME PËRPIKËRI RREGULLAT E MËSIPËRME!